



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Gjiçanit**  
**Opština Gnjilane**  
**Municipal Gjiçan**  
**Gilan Belediyesi**

---

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nenit 18 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 04/L-149 dhe nenit 11 të Ligjit për Bibliotekat, nr. 04/L-097, Komuna e Gjiçanit shpall;

## **KONKURS PUBLIK**

### **Për plotësimin e pozitës punuese**

#### **Zyra e Kryetarit**

#### **Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport**

Titulli i punës: **Drejtor i Bibliotekës**

Lloji i pozitës: **E mandatar - jo e karrierës**

Koeficienti: **8**

Kategoria funksionale: **Niveli drejtues**

Orari i punës: **i plotë**

Titulli i mbikëqyrësit: **U Udhëheqësi për NJKRS**

Procedura e aplikimit: **i jashtme**

Nr. i ref. **JP00029377**

**Qëllimi i vendit të punës:** Menaxhimi dhe Promovimi i Bibliotekës:

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë :**

- Drejtori i bibliotekës udhëheq, organizon dhe mbikëqyrë veprimtarinë dhe funksionimin e bibliotekës amë dhe degët e saja;
- I propozon Këshillit drejtues të bibliotekës planin vjetor dhe financiar të punës;
- Për punën e tij i raporton dhe i përgjigjet Këshillit Drejtues;
- përfaqëson bibliotekën brenda dhe jashtë vendit;
- Merr pjesë në mbledhjen e Këshillit Drejtues pa të drejtë vote;
- Bashkëpunon me bibliotekat vendore dhe jashtë vendit;
- Koordinin debate, trajnime, seminare dhe panairë për bibliotekë në regjion;
- Ushtron detyra dhe autorizime tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;

## **Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Diplomë universiteti nga fusha e Bibliotekarisë ose lëmi të përafërta;
- Të ketë 4 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit
- Të ketë njohuri të punës me kompjuter, Word, Excel;
- Të ketë shkathtësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe ndër njerëzore ;
- Të ketë aftësi të mira për ruajtjen dhe zhvillimin e kontakteve brenda dhe jashtë Bibliotekës.

**Rregullimi i mandatit:** bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Ligjit për Bibliotekat nr. 04/L-097, mandati i Drejtorit të Bibliotekës të Qytetit është 4 (katër) vite me mundësi rizgjedhjeje.

**Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (foto kopje) si vijon :**

1. dëshmi të kualifikimit shkollorë në fotokopje e noterizuar, nëse kandidati e ka kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës diploma duhet të jetë e nostrifikuar në MASHT.
2. dëshmi mbi përvojën e punës dhe trajnimet e kryera
3. dokumentin e identifikimit;
4. certifikata që nuk është nën hetime dhe i dënuar

Aplikacionet merren dhe të plotësuar dorëzohen në arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve

Afati i aplikimit është **15** ditë, nga dita e shpalljes publike në gazetë ditore, Web faqen komunale dhe në tabelen Komunale të shpalljeve edhe atë prej **23.06.2017 e deri më 07.07.2017**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për testim dhe intervistë përmes emailit.

Shërbimi Civilë i Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç parashihet në nenin 11 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.**

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta rrefuzohen.